



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrašnjih Poslova - Ministry of Internal Affairs*

Akademia e Kosovës për Siguri Publike/ Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost  
Kosovo Academy for Public Safety

---

KONFERENCA E III-të NDËRKOMBËTARE

SFIDAT E FUNKSIONIMIT TË INSTITUCIONEVE TË SIGURISË PUBLIKE NË  
RRETHANA TË PANDEMISË COVID-19

25 nëntor, 2020  
AKSP, Vushtrri, Kosovë

## THIRRJE PËR PJESËMARRJE

KONFERENCA E III-të NDËRKOMBËTARE  
AKSP, Vushtrri, Kosovë  
25 nëntor 2020

SFIDAT E FUNKSIONIMIT TË INSTITUCIONEVE TË SIGURISË PUBLIKE NË  
RRETHANA TË PANDEMISË COVID-19

### Thirrje për aplikim

Akademia e Kosovës për Siguri Publike më 25 nëntor 2020 organizon konferencën e III-të shkencore ndërkombëtare me titull "*Sfidat e funksionimit të institucioneve të sigurisë publike në rrethana të pandemisë COVID-19*".

Pandemia globale COVID-19 krijoi gjendje sfiduese në të gjitha fushat, veçanërisht në fushën e sigurisë publike si shumë e rëndësishme në funksionimin e shtetit dhe sigurimin e mirëqenies. Bota sot po përballet me një virus ende të panjohur sa duhet, që vështëroi jetën e qytetarëve në mbarë botën si dhe punën e institucioneve shëndetsore, arsimore dhe atyre të sigurisë, të cilat ishin të detyruara të vepronin ngandonjëherë edhe pa bazë adekuate ligjore, përgatitje teknike, personel etj., duke e bërë punën e tyre edhe më të vështirë.

Konferenca synon të bashkojë studiuesit e fushave të sigurisë publike me qëllim të prezantimit të modeleve të institucioneve të sigurisë publike, arsimore dhe trajnuese të vendeve të tyre, përvojat, sfidat e kaluara dhe aktuale në rrethana të pandemisë globale COVID-19.

Kosova, si çdo vend tjetër, ka nevojë për të mësuar nga përvojat dhe rezultatet e arritura gjetiu. Konkluzionet që do të dalin nga kjo konferencë si rezultat i një diskutimi shkencor, do të jenë një kontribut i çmuar për institucionet e sigurisë publike dhe institucionet tjera në përballimin dhe tejkalimin e sfidave të kësaj pandemie.

**Prandaj ftohen të marrin pjesë akademikët, studentët, hulumtuesit dhe profesionistët e tjerë që të prezantojnë pikëpamjet e tyre.** Konferenca do të mbahet *online* në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze me përkthim simultan në gjuhët e lartërcekura.

## Datat e rëndësishme dhe modeli i pjesëmarrjes në konferencë

Punimet dhe prezantimet nuk duhet të kenë qenë të botuara apo prezantuara më parë gjetiu.

Datat e rëndësishme për konferencë janë si në vijim:

- Dorëzimi i abstrakteve deri më 28 gusht 2020
- Njoftimi i pranimit më 10 shtator 2020
- Dorëzimi i punimeve deri më 20 tetor 2020
- Njoftimi i pranimit të punimit të dërguar së bashku me programin e plotë të konferencës më 5 nëntor 2020
- Data e mbajtjes së konferencës më 25 nëntor 2020

Abstrakti duhet të përmbajë 200–300 fjalë dhe të dërgohet në e-mail adresën [konferenca.aksp@rks-gov.net](mailto:konferenca.aksp@rks-gov.net).

Abstraktet e dorëzuara duhet të përgatiten në përputhje me udhëzimet e mëposhtme:

- Gjuhët zyrtare të konferencës janë shqip, serbisht dhe anglisht. Abstrakti i punimeve të paraqitura në gjuhën shqipe dhe serbe duhet të dërgohet edhe në gjuhën angleze;
- Të përmbajë emrin e plotë të autorit/autorëve, përkatësinë institucionale dhe e-mail adresën;
- Teksti të shkruhet dhe shtypet me hapësirën 1.15 ndërmjet rreshtave në fontin "Time New Roman" dhe madhësia e shkronjave të jetë 12.

Pas dorëzimit dhe vlerësimit të abstrakteve, sipas datave të lartëcekura, autorët do të njoftohen për pjesëmarrjen e tyre në konferencë. Autorët e punimeve të cilat i plotësojnë standardet e kërkuara, pas vlerësimit nga Bordi, do të njoftohen në mënyrë të detajuar për pjesëmarrje në konferencë. Autorët e pranuar me kohë do të njoftohen me strukturën dhe standardet e punimit shkencor, në bazë të të cilit do të përgatiten dhe dorëzohen punimet.

Për çdo pyetje lidhur me konferencën, ju lutem të mos hezitoni të kontaktoni komisionin për organizimin e konferencës [konferenca.aksp@rks-gov.net](mailto:konferenca.aksp@rks-gov.net), si dhe personin kontaktues Prof. Ass. Dr. Nexhat Jashari, [nexhat.jashari@assembly-kosova.org](mailto:nexhat.jashari@assembly-kosova.org), tel. +383 (0)44 147 264.

Informacione mund të gjenden në faqen zyrtare të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike <http://www.aksp-ks.net/>, në shtyllën "Fakulteti i Sigurisë Publike/Hulumtimet/ Konferenca" <http://www.aksp-ks.net/fsp/?page=1,39>.

Do t'iu ishim mirënjohës nëse ju e ndani këtë thirrje për pjesëmarrje të konferencës edhe me kolegët dhe personelin tuaj. Ju faleminderit paraprakisht për interesimin tuaj.